



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE ,MJEDISIT BUJQESISE ,PYJEVE DHE
KULLOTAVE

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2025

SPECIFIKIME TEKNIKE

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Projekti ndodhet bashkengjitur ne formatin A3

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER PUNIME N D E R T I M U R E

TË PËRGJITHËSHME NJESITE E MATJES

PROGRAMI DHE EKZEKUTIMI I PUNIMEVE SIGURIMI I LEVIZJES

ZHVILLIMI I PUNIMEVE ZEVENDESIMET

DOKUMENTAT DHE VIZATIMET

KOSTOT E SIPERMARRESIT PER MOBILIZIM DHE PUNIMET E PERKOSHME HYRJA NE
SHESHIN E NDERTIMIT

FURNIZIMI ME UJE

FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE PIKETIMI I PUNIMEVE

MBROJTJA E PUNES DHE E PUBLIKUT MBROJTJA E AMBJENTIT

TRASPORTIMI DHE MAGAZINIMI I MATERJALEVE

SHESHI DHE MAGAZINIMI

KOPJIMI I VIZATIMEVE (VIZATIMET SIC JANE ZBATUAR) PASTRIMI PERFUNDIMTAR I
ZONES PRODUDUKTET E NDERTIMIT

REZISTENCA MEKANIKE DHE QENDRUSHMERIA SIGURIA NE VENDOSJEN PROVAT



1.1 TE PERGJITHESHME

Paragrafet në këtë kapitull janë plotësuese të detajeve të dhëna në Kushtet e Kontrates.

QELLIMI

Ne keto specifikime teknike perfshihen te gjitha zerat e punimeve ndertimore, te percaktuara ne projektin e zbatimit, simbas vizatimeve perkatese dhe pershkrimeve te relacionit teknik.

Ne keto specifikime jepet zhvillimi i punimeve dhe kerkesat teknike per zbatimin e projekteve, te hartuara nga DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE , sipas kerkesave te Bashkise Elbasan.

Te gjitha kerkesat teknike te percaktuar ne keto specifikime jane te detyrueshme per kontraktorin e punimeve. Projektet permbajne te gjitha te dhenat e nevojshme per zbatimin e punimeve, bazuar ne matje te sakta te kryera ne terren.

Per çdo mos perputhje te te dhenave te projekteve me gjendjen ne terren, te behet azhornimi i tyre nga zbatuesi i punimeve, dhe ne konsultim me mbikqyresin e punimeve dhe projektuesin, te behen ndryshimet perkatese te cilat do te aprovohen nga punedhenesi.

Per zerat e punimeve qe nuk perfshihen ne keto specifikime, te hartohen specifikime te vecanta nga mbikqyresi i punimeve dhe te aprovohen nga punedhenesi.

Keto specifikime jane hartuar ne perputhje me standartet shteterore dhe kushtet teknike te projektimit e zbatimit te punimeve ne fuqi. Ne se kontraktori deshiron te aplikojte standarte te tjera atehere ai do te marre aprovimin nga punedhenesi dhe mbikqyresi i punimeve.

1.2. NJESITE E MATJES

Ne pergjithesi njesite e matjes qe perdoren ne keto specifikime jane te sistemit metrik ne mm, cm, km, N (Njuton), Mg (1000kg) dhe shkallezimi celsius (8). Jane perdorur dhe ngarkesat ne Ton, T dhe t ne vend te (Mg).

Eshte perdorur dhe sistemi i njesive S I, sidomos ne provat e materialeve dhe matjet me paisje te ndryshme. Interpretimi i njesive matese te behet sipas shenjave konvecionale te vendosura perbri numrave, ne perputhje me standartin qe i referohet.



1.3. PROGRAMI DHE EKZEKUTIMI I PUNIMEVE

Para fillimit të punimeve kontraktori duhet të marrë masat për kryerjen e të gjitha punëve përgatitore në kanton dhe në sheshin e ndërtimit. Për këtë është e nevojshme hartimi i një programi të detajuar i cili do të aprovohet tek mbikqyesi i punimeve.

Merret i gjithë informacioni i nevojshëm për zonën ku do të kryhen punimet, duke bashkëpunuar me mbikqyresin dhe punëdhënësin. Kur është e nevojshme të bashkëpunohet me hartuesin e projektit.

Njohja me projektin dhe problemet që dalin për zbatimin e tij në terren. Merren të dhëna për gjendjen e objektit, veprave të artit, rrjetit inxhinierik etj dhe verifikohen ato me projektin.

Verifikohen pikat fikse të vendosura në terren nga Projektuesi .

Percaktohet natyra e dherave dhe në funksion të tyre dhe punimeve percaktohen makineritë që do të përdoren në sektore të ndryshëm.

Percaktohen vendmarrjet e materialeve dhe vendet e depozitimit të tyre.

Percaktohen dhe bëhet lidhja me energji elektrike, ujësjellës, telefoni etj, për kantonet dhe nyjet e prodhimit e përpunimit të materialeve.

Hartohet projekt-organizimi i punimeve të objektit dhe për objekte të veçanta.

Për të gjitha veprimet e mësipërme është e nevojshme që kontraktori të marrë aprovimin nga mbikqyesi i punimeve.

Për materialet e mbushëse (gurë kave) të gabjonit që do të përdoren për ndërtimin e pritave tërthore dhe materialet e mbushëse zhavor lumi që do të përdoren për mbushje kontraktori është përgjegjës për të gjetur karrjerat e përshtatshme të miratuara nga Agjencia e Basenit Shkumbin , duke marrë në konsideratë bisedimet me Pushtetin Vendor, duke përgatitur dhe nënshkruar marrëveshje ligjore, duke bërë pagesën, etj.

1.4. SIGURIMI I LEVIZJES

Për zhvillimin normal të punimeve, në bashkëpunim dhe me autoritetet lokale, percaktohet mënyra e levizjes së mjeteve gjatë zhvillimit të punimeve. Levizja e mjeteve do të sigurohet duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë për kalimin provizor të tyre në rrugët dytësore .

Për të gjitha kalimet provizore është e nevojshme të merren masa për përmirësimin e tyre në atë shkallë që të garantojnë një levizje normale dhe të sigurtë të mjeteve që levizin në këtë aks dhe

Për të gjitha masat që do të merren është e domosdoshme të merret aprovim nga mbikqyesi i punimeve dhe autoritetet lokale.



1.5. ZHVILLIMI I PUNIMEVE

Percaktimi i rradhes se zhvillimit te punimeve, eshte bere per zbatimin e menjehershem te te gjithë projektit, ne kushte optimale, qe te kemi koston me te ulet, sipas vleresimeve te percaktuara ne preventivat perkates. Per çdo ndryshim te bere nga keto percaktime eshte i nevojshem bashkepunimi me projektuesin.

1.6. ZEVËNDESIMET

Zëvendëimi i materialeve të specifikuara në Dokumentin e Kontratës do të behet vetem me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve në se materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose me i mirë se materialet e specifikuara, ose në se materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të çertifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

1.7. DOKUMENTAT DHE VIZATIMET

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasi të dhe detajet të treguar në vizatimet, grafikët ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Sipërmarrësin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Sipërmarrësi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve e volumeve, llojeve dhe sasive të materialeve dhe paisjeve të përfshira në punën që duhet kryer sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhezim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi në se do të gjenden gabime të tilla ose mospërputhje.

1.8. KOSTOT E SIPERMARRESIT PER MOBILIZIM DHE PUNIMET E PERKOSHME

Do të kihet parasysh që Sipërmarrësit nuk do ti bëhet asnjë pagesë mbi çmimet njësi të kuotuar për kostot e mobilizimit, d.m.th. për sigurimin e transportit, dritën, energjinë, veglat dhe pajisjet, ose për furnizimin e godinës dhe mirëmbajtjen e impjanteve të ndërtimit, rrugëve të hyrjes, të komoditeteve sanitare, heqje e mbeturinave, punën, furnizimin me ujë, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punës, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura të tjera të përkohëshme, paisje dhe materiale, ose për kujdesin mjekësor dhe mbrojtjen e shëndetit, ose për patrullat dhe rojet, ose për ndonjë shërbim tjetër, lehtësi, gjëra, ose materiale të nevojshme ose që kërkohen për zbatimin e punimeve në përputhje me atë që është parashikuar në Kontratë.



1.9. HYRJA NE SHESHIN E NDERTIMIT

Sipërmarrësi duhet të organizojë punën për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe më pas të spostojë dhe të rivendosë çdo rrugë hyrje që do të duhet në lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do të përfshijë përshtatjen e zonës me çdo rrugë hyrje dhe, së paku me shkallë sigurie, qëndrueshmërinë dhe kullimin e ujërave sipërfaqësore të njëjtë me atë që ekzistonte përpara se Sipërmarrësi të hynte në Shesh.

1.10. FURNIZIMI ME UJE

Uji që nevojitet për zbatimin e punimeve do të merret nga pika më e afërt e mundëshme. Sipërmarrësi do të shtrijë rrjetin e vet të përkohshëm me shpenzimet e veta, duke bërë vetë përpjekjet për furnizimin me ujë të pastër për punimet.

1.11. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Sipërmarrësi do të bëjë përpjekjet dhe me shpenzimet e tij për furnizimin me energji elektrike në kantier, si me kontraktim me KESH – in nëpërmjet nënstacionit më të afërt në se lidhja me të është e mundur, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet për të përmbushur kërkesat.

1.12. PIKETIMI I PUNIMEVE

Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave siç është parashikuar në projekt në përputhje me informacionin bazë të Punëdhënësit, dhe do të jetë përgjegjësi i vetëm për përpikmerinë dhe saktësinë e tyre. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij në se një

1.15. MBROJTJA E AMBJENTIT

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që rrjedhjet ujore, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mos plotësimi i kësaj klauzole në bazë të evidentimit nga Mbikqyrësi i Punimeve, mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

Vepra duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të mos kompromentojë higjienë ndërtimit të destinuar për tu aplikuar në vepër. Informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohë do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punëdhënësi dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korrigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarrësi do të furnizojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e tij rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nëpërmjet një stafi të kualifikuar siç mund të kërkohet nga Punëdhënësi për kontrollin e modinave dhe piketave.



Sipërmarrësi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shënjat e kuotave, të bëra ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato dëmtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes, mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndërtimor, Sipërmarrësi do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejtën e kalimit të qartë dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punëdhënësi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarrësi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë gjithmonë nën drejtimin e Mbikqyrësit të Punimeve.

1.13. FOTOGRAFITE E SHESHIT TE NDERTIMIT

Sipërmarrësi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sips udhëzimeve të Mbikqyrësit të Punimeve në vëndet e punes për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit të punimeve, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Për fotografimin e kantierit të punimeve nuk do të bëhen pagesa, pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nën koston administartive të Sipërmarrësit.

1.14. MBROJTJA E PUNES DHE E PUBLIKUT

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtoreve të punësuar dhe të jetës publike si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikueshme, kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shënja me dritë të kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues në të gjitha vëndet ku punimet mund të shkaktojnë çrregullime të trafikut normal ose që përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

1.16. TRASPORTIMI DHE MAGAZINIMI I MATERJALEVE

Transporti i çdo materiali nga Sipërmarrësi do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatëshme për ti mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

1.17. SHESHI DHE MAGAZINIMI

Sipërmarrësi duhet të bëjë me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e një terreni të mjaftueshem për ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij



1.18. KOPJIMI I VIZATIMEVE (VIZATIMET SIC JANE ZBATUAR)

Sipërmarrësi duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë faktikisht zbatuar” në terren. Vizatimet do të bëhen në një standart të ngjashëm me atë të vizatimeve të Kontratës.

Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Sipërmarrësi do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “Vizatimeve siç janë zbatuar”. Do të shenojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar, material i cili do të jetë i disponueshëm në çdo kohë gjatë zbatimit për Menaxherin e Projektit. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t'i dorëzohen Mbikqyrësit të Punimeve çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lëna gjatë gërmimeve dhe vendosjen ekkzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Sipërmarrësi gjithashtu duhet të përgatisë profilat gjatësore dhe seksionet tërthore të rishikuara, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gërmimit.

Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve “ siç janë zbatuar ” do t'i dorëzohen Mbikqyrësit të

Punimeve për aprovim. Vizatimet “siç janë zbatuar”, të aprovuara, do të bëhen pronë e Punëdhënësit.

Për bërjen e Vizatimeve “siç janë zbatuar” dhe Manualeve nuk do të bëhen pagesa, pasi kosto e tyre është parashikuar të mbulohet nga shpenzimet administrative të Sipërmarrësit.

1.19. PASTRIMI PERFUNDIMTAR I ZONES

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme, Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lerë sheshin e tërë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa përfundimtare e Kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Mbikqyrësi i Punimeve.

1.20. PRODUDUKTET E NDERTIMIT

Produktet e ndërtimit të destinuar për tu aplikuar në vepër, duhet të kenë karakteristikat e tilla që veprat në të cilat do të aplikohen këto produkte, të mundet të plotsojnë kërkesat thelbësore të konstruksionit.

Kërkesat thelbësore të sigurisë kanë të bëjnë me veprat brenda së cilave produktet do të jenë përjetësisht të inkorporuar

1.21. REZISTENCA MEKANIKE DHE QENDRUSHMERIA

Vepra duhet të konceptohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që për forcat të cilat veprojnë mbi këto struktura gjatë fazës së ndërtimit dhe shrytëzimit të mos provokojnë:



1. Shembjen e të gjithë veprës ose të një pjese të saj
2. Deformime përtej atyre të lejuara
3. Dëmtime aksidentale

1.22. SIGURIA NE VENDOSJEN

Vepra duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që përdorimi i saj të mos shkaktojë aksidente të tipit rrëshqitje, rënie, erozione , etj.

Veprimet ndaj të cilave elementi është objekt gjatë lëvizjes shkaktohen nga pesha vetjake të rritura me 15% për të marrë në konsideratë efektet dinamike, për këtë arsye konsiderohet një ngarkesë, për elementin me përmasa 100x100x100 e barabartë me 18.4 KN.

1.23. PROVAT

Ky seksion përfaqëson procedurat e kryerjes së provave për materialet e ndërtimit me qëllim që të sigurojë dhe përputhje me kërkesat e Specifikimeve.

Për punimet e betonit dhe të hekurit të armimit në objekte të ndryshme do të kryhen provat e mëposhtme: Dhënia e recetës së betoneve për klasat e betonit sipas projektit, bazuar në materialet që do të përdoren, pasi të jenë përcaktuar më parë karakteristikat e materialeve përbërëse të betonit (çimento, inerte).

Shpërndarja e madhësisë së grimcave e materialeve inerte të betonit (Granulometria) gjatë periudhës së ndërtimi.

Provat e çimentos (rezistenca 3,7 dhe 28 ditore, fillim – mbarim i prezës

Rezistenca në shtypje e betonit gjatë periudhës së ndërtimit, bazuar në standartet shqiptare

Rezistenca në tërheqje e hekurit të ndërtimit për çdo lloj diametri të përdorur. Zgjatimi relativ i hekurit të ndërtimit

Standartet per Kryerjen e Provave

Të gjitha provat do të bëhen në përputhje me metodat standarte shqiptare ose me të tjera ndërkombëtare të aprovuara më parë nga mbikqyrësi i punimeve.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marrjes së kampioneve do të jetë siç është specifikuar në metodat e aplikueshme të marrjes së kampioneve dhe të kryerjes së provave ose siç udhëzohet nga Mbikqyrësi i Punimeve.

Frekuenca e kryerjes së provave do të jepet nga Mbikqyrësi i Punimeve. Marrja e ndonjë kampioni shtesë mund të rekomandohet po nga Mbikqyrësi i Punimeve.



Enë të tilla si çanta, kova e të tjera, do të jepen nga Sipërmarrësi. Marrja e mostrave për provë do të kryhet nga Sipërmarrësi në vëndet dhe periudhat që udhëzon Mbikqyesi i Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre në laborator do të bëhet nga Sipërmarrësi.

KAPITULLI II - PUNIMET E GERMIMIT DHE MBUSHJEVE TE ZHAVOREVE

PUNIMET E GERMIMIT PER THEMELIN E KEMBEVE TE URES DHE MUREVE TE SPERONAVE

Ne zerin “germim dheu per themel” perfshihen te gjitha punimet e nevojshme qe duhet te kryhen per realizimin e profilit gjatesor te tij ne perputhje me projektin e dhene. Per realizimin e ketyre punimeve , pervecse sa me siper duhet te mbahen parasysht edhe :

Per realizimin e punimeve te dherave , ne germim apo mbushje, ne te gjitha rastet , me pare eshte e detyrueshme te behet perpunimi i bazamenteve duke realizuar se pari, skarifikimet , dhe largimet e materialeve te papershtatshem. Te gjitha punimet per germime apo mbushje per formimin e seksionit terthor ku do te mbeshtetet tombino boks, do te behen ne perputhje me seksionin tip dhe specifikimet teknike qe shoqerojne kete projekt . Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te germimeve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet ne te cilat percaktohen permasat e germimeve.

Cdo germim pertej limiteve të percaktuara në keto vizatime, nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Mbikqyesi i Punimeve. Megjithate, nese germimi eshte me pak se volumi i llogaritur nga vizatimet, do te paguhet volumi faktik i germimeve sipas matjeve faktike.

Punimet e germimit parashikohen te realizohen me eskavator per devijimin e lumit do te shkarkohen ne toke dhe do te perdoren per mbushje me pas.

Te gjitha shpenzimet dhe lejet e nevojshme per punimet ne lume do te perballohen ne firma e zbatimit.

2.1. PUNIMET E GERMIMIT PER THEMELIN E SPERONAVE

Germimet do te kryhen sipas kontureve dhe vizatimeve te projektit per kete objekt . Mbasi te jete arritur ne konturet dhe kuotat e projekti, firma zbatuese se bashku me supervizorin, topografin, gjeologun bejne azhornimin dhe dokumentimin e punimeve te kryera.

Punimet e germimit do te behen sipas profilave terthor te projektit.

Mbasi eshte percaktuar nga matjet topografike kufiri i poshtem i themelit te murit te speronave , behet modinimi sic eshte percaktuar ne profilin terthor.

Germimet per themelin e speronave duhet patur kujdes sidomos kur lartesia e germimit kalon 3 m pasi fomacioni i tokes eshte i ngopur per rrjedhoje eshte i paqendrueshem prandaj germimi duhet te



respektoje vizatimet e projektit si dhe mund të bëjë forçimin në raste kur ka edhe prezencë të madhe të ujërave nentokesore.

Në rastin kur gjatë hapjes së themelit rezultojnë bazamenti i papershtatshëm, me aprovimin e inxhinierit, gërmimi do të vazhdojë deri në tabanin e pershtatshëm.

Punimet e gërmimit do të kryhen me makineri të pershtatshme me krah mbi 6m.

Gjatë gërmimit do të respektohen të gjitha kushtet teknike të zbatimit të punimeve dhe sigurimi teknik.

2.2. PUNIMET MBUSHJE ME ZHAVORE

2.2.1. PUNIMET E MBUSHJES ME ZHAVORR PËR MBUSHJET MBI MIDIS SPERONAVE

Punimet e mbushjeve do të bëhen sipas profilit gjatësor dhe profilave terthor të projektit.

Perpara fillimit të mbushjes me zhavorr do të bëhet nivelimi i bazamentit dhe me pas mbushja me zhavorr të sjellë me auto.

Shtresat rrugore janë përcaktuar në profilat terthor tip, për çdo segment rruge. Çdo devijim nga projekti do të bëhet me miratimin nga mbikqyesi i punimeve dhe projektuesit. Trashësia e shtresës është dhënë mesatare. Në këto shtresa do të jepet pjerësia terthore, zgjerimi në kthesa, profilimi i trupit të rrugës sipas kuotave të projektit dhe mbushja e gropave të demtuara që do të skarifikohen me parë.

Shtrimi i do të bëhet pasi të jete bërë skarifikimi i dherave e materjaleve të papershtatshëm dhe nivelimi i shtresave ekzistuese. Skarifikimi i shtresave ekzistuese do të bëhet deri në nivelin e shtresave ekzistuese të pa demtuara, të cilat do të përcaktohen në vend nga mbikqyesi i punimeve, sipas përcaktimeve të dhëna në projekt dhe këto specifikime.

Hedhja dhe përhapja e materialit do të bëhet me makineri ose krahe, pasi të merret aprovimi i mbikqyresit për gjendjen e shtresës së hedhur me parë. Shmangiet e lejuara në trashësi, pas ngjeshjes, janë: + 5 cm dhe – 2 cm.

Shtrimi i materialit do të bëhet me breza terthor me gjatësi 0.5 □ 1.0 m për çdo 20 m, të cilat do të kontrollohen në kuotë pas përfundimit të tyre dhe pas kësaj mbushet pjesa tjetër. Gjatë shtrimit të jepet pjerësia terthore e rrugës sipas kuotave të profilave terthore të projektit.

Materiali i ngjeshur në veper duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Indeksi i plasticitetit IP □ 10.
 - CBR minimale 30 %
 - Densiteti minimal i matur në shtresat e ngjeshura dhe të thata duhet të jete 95 % e vlerës Proktor i modifikuar.



Shtresa e çakullit të minave ose zhavorit është parashikuar të behen me çakull natyral të nxjere nga karierat e gurit me shperthime minash ose material tjetër guror ose lumor, që plotëson kërkesat e mëposhtme:

- Materiali guror duhet të ketë fortësi $\geq 800 \text{ kg/km}^2$.
- Marka e termimit, nga prova Losanxhelos LA $\leq 30 \%$.
- Permbajtja e argjilës duhet të jetë me pak se 8 % dhe e mbeturinave bimorë me pak se 5 %.
- Dimensioni maksimal i kokrizave nuk duhet të kalojë 2/3 e trashësisë së shtresës.

Granulometria duhet të jetë e vazhduar me modul shkallëzimi sipas tabelës më poshtë:

Dimensioni i sites në mm	Section 1.01 Perqin dja e kalimit sipas peshës (%)
100	100
75	80 - 100
40	60 - 85
25	50 - 70
10	40 - 55
5	30 - 50
2	20 - 35
0.4	10 - 20
0.075	7 - 15

Për arritjen e treguesve të mesipër është e nevojshme të behet ngjeshja me rul me peshë 10 □ 14 ton duke bërë 8 kalime në një vend. Gjate ngjeshjes është e nevojshme të behet sperkatja me ujë për të arritur lageshtinë optimale, të përcaktuar në laborator (rekomandohet 6 □ 10 %).

Në pjesët e seksionit të rrugës që nuk futet ruli i madh (10 □ 14 ton) ngjeshja do të behet me rul vibrues 6 □ 8 ton duke bërë minimum 12 kalime në një vend.

Ngjeshja do të behet duke filluar nga anët në drejtim të mesit të rrugës. Çdo kalim i mëvonshëm duhet të shkele gjurmen e mëparshëm minimum 25 cm.



Mbas ngjeshjes behet plotesimi me material te imet ne pjeset ku ka perqendrim te materialit te trashe. Ne qofte se gjate ngjeshjes konstatohen vende me deformime si rezultat i materjalit jo te mire, hiqet kjo pjese e shtreses dhe zevendesohet me materjal te pershtatshem.

KAPITULLI IV - PUNIMET E BETONIT TE PERGJITHSHME

Qellimi i punes qe perfshin ky kapitull eshte zbatimi i procesit te betonimit konform standarteve, kushteve teknike dhe kerkesave te projektit gjate ndertimit ose rehabilitimit te linjave te Ujesjellesit, Kanalizimeve dhe Punimeve ne Rezervuare. Kryerja e ketij procesi duhet te behet me makineri perkatese (perzieres betoni, transportues betoni, vibrator mekanik, etj) veglat e punes, materiale dhe pajisje te tjera speciale (pompa, pajisje topografike, etj) qe jane te domosdoshme per perfundimin ne sasine dhe cilesine e duhur te ketij procesi.

Ne fillim te Kontrates, Kontraktori duhet te paraqese tek Supervizori propozimin e tij per organizimin e aktiviteteve te betonimit ne shesh i cili duhet te permbaje:

Vendosjen dhe shtrirjen e pajisjeve te prodhimit te betonit

- ☐ Metodatat e propozuara per organizimin e pajisjeve te prodhimit te betonit
- ☐ Procedurat e kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit
- ☐ Transporti dhe hedhja e betonit
- ☐ Detaje te punes se berjes se kallepeve duke perfshire kohen e heqjes se kallepeve dhe procedurat per mbeshtetjen e perkoheshme te trareve dhe soletave qe do te vendosen

KONTROLLI I CILESISE

Kontraktori duhet te kete ne stafin e tij kyc nje inxhinier ndertimi te kualifikuar, te specializuar, me licencen perkatese dhe me eksperience, i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise se te gjitha betoneve.

Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur.

Kontrolli i cilesise do te behet konform Kushteve teknike dhe standarteve perkatese ne prezence te Inxhinierit dhe Supervizorit te Punimeve te cilet do te jene edhe pergjegjes per cilesine e betoneve te hedhura ne veper.

PUNA PREGATITORE DHE INSPEKTIMI

Perpara se te kryhet procesi i pregatitjes se llacit ose te betonit, zona brenda aramaturave duhet te jete e pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar.

Asnje proces betonimi nuk duhet te kryhet derisa Supervizori te kete inspektuar dhe aprovuar (ne se eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per



shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim te betonit, fugat ndertimore dhe fiksimin fundeve, armimin si dhe te gjitha materialet

e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi.

MATERIALET

a- Cimento

Nje nder materialet me te rendesishme qe perdoren per betonet dhe qe duhet ti nenshtrohen kontrollit teknik te Supervizorit eshte cimento.

Gjate betonimeve mund te perdoren dy lloje cimento (me perjashtim te rasteve kur ka kerkesa specifike nga projektuesi) si me poshte:

□ Cimento Portland e zakonshme do te perdoret sipas standarteve te ISO ose ASTM C-150, tipi II ose Tipi

V. Kjo lloj cimento do te perdoret per betonet qe nuk jane ne prezence te ujrave, ujrave te zeza, tubave te gazit apo ujrat nentokesore.

□ Cimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret sipas standarteve te ISO, BS 4027 ose ASTM C-

150, tipi II ose Tipi V. Kjo lloj cimento do te perdoret per betonet qe jane ne prezence te ujrave, ujrave te zeza, tubave te gazit apo ujrat nentokesore.

Cimento duhet te shperndahet ne paketa orgjinale te shenuara, te pademtuara, direkt nga fabrika dhe te ruajtura ne kushtet e duhura ne nje depo te pershtatshme dhe te ajrosur. Thaset e cimentos duhet te jene te

vendosur te pakten 15 cm mbi sip. e tokes. Cimento nuk duhet te qendroje me shume se tre muaj ne kantier pa lejen e supervizorit.

Cdo lloj cimento e ngurtesuar apo e demtuar nuk duhet te perdoret. Cdo dergese e Cimentos duhet te jete e shoqeruar me certifikaten e cilesise dhe flete analizat perkatese te fabrikes prodhuese.

Cimento e perftuar nga pastrimi i thaseve te cimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret.

Supervizori ka te drejte te kerkoje ritestimin e cimentos kur ka dyshime mbi cilesine e saj apo gjendjen aktuale

b- Inerttet

Inerttet per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH - 512 - 78 ose ne perputhje me

ASTM C 33



Ato duhet te jene te paster, te forte, te qendrueshem, dhe nuk duhet te permbajne lende organike ose masa te tjera te demshme qe veprojne kunder fortesise dhe qendrueshmerise se betonit apo te betonarme.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet e njohura dhe te licensuara qe sigurojne rezultate te kenaqshme per te gjitha llojet e betoneve.

Inertet e perdorura do te jene te imta dhe te trasha. Ato do te perdoren sebashku ne betonet sipas nje raporti te dhene ne Kushtet Teknike perkatese dhe me aprovimin e Supervziorit te Punimeve.

Me poshte po japim detaje per seicilen prej llojeve te inerteve:

□ **Inertet e Imta**

Inertet e Imta per kategorite e betonit A,B,C (Betone me marke M100, M200, M300) konform STASH 512-

78 do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete e pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, ergjile dhe sasi te substancave te tjera demtuese. Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5 %.

Materialet e marre nga gure te papershtashme per inerte te trasha nuk duhet te perdoren per inerte te imta. Shkalla e shperndarjes per inertet e imta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem.

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
10,0 mm	100
5,0 mm	90 - 100
2,4 mm	60 - 100
1,2 mm	30 - 100
0,6 mm	15 - 100
0,3 mm	5 - 70
0,15 mm	0 - 15

Inertet e imta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, plehra,etj. Ato nuk duhet te permbajne me shume se 10 % te materialit me te holle se 0,1 mm te hapesires ne rrjete dhe jo me shume se 5 % te pjeses se mbetur ne 2,4 mm site.

□ **Inertet e Trasha**

Inertet e trasha per kategorite A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjerre ose nje



kombinim i tyre me nje mase jo me shume se 20 mm dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lend organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne Inertet e trasha nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te secifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
50,0 mm	100
37,5 mm	90 - 100
20,0 mm	35 - 70
10,0 mm	10 - 40
5, 0 mm	0 - 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare. Ato nuk duhet te permbajne kashte, rere ose materiale te huaja apo mbeturina te tjera.

Raportet e Inerteve te trasha dhe te imta

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Supervizori mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes ne se do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura ne perzierjen e inerteve te trasha dhe te imta

Kontraktori duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzierjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imta apo te trasha ose ne burimin e e tyre te furnizimit.

Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta. Kubiket duhet te testohen nga 7, 14 deri ne 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave, Supervizori i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzierje te mevonshme gjate zhvillimit te punesose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte

c- Uji per Beton

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasterti organike vegjetale dhe pa

kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovohet nga Supervizori i punimeve. Nuk duhet te perdoret uje nga germimet, kullimet siperfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cielsore duhet te perdoret per larjen e pastrimin e araturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.



METODAT DHE KERKESAT PER PERZIERJEN E BETONEVE

Betoni duhet te perzihet me perzieresa mekanike te miratuara qe me pare. Perzieresi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe nga era.

Inertet dhe cimento duhet te perzihen se bashku para se te shtohet uje derisa perzierja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur.

Kerkesat per perzierjen e betonit duhet te konsistojne ne ndarjen proporcionale dhe perzierjen per fortesite e meposhtme kur behen testet e kubikeve;

Klasa e betonit Fortesia ne shtypje ne N/mm^2 , pas 28 ditesh

R_{ck}	f_{ck}	
C – 8/10	10	8
C- 12/15	15	12
C -16/20	20	16
C -20/25	25	20
C -25/30	30	25
C -30/37	37	30
C -35/45	45	35
C -40/50	50	40

Rezistenca ne shtypje e betonit eshte shprehur ne termat e rezistences karakteristike percaktuar si vlera e rezistences nen te cilen 5% e numurit te pergjithshem te provave te rezistences te betonit te specifikuar supozohet te ndodhin.

Rezistenca do te percaktohet ne perputhje me ISO 4012 ne shkaterrimin e mostres - kubik 150/150/150 mm si

R_{ck} (cube) ose cilinder 150 / 300 mm , f_{ck} (cyl) ne kohe 28 dite, ne pajtueshmeri me ISO 1920, kryer dhe trajtuar sipas ISO 2736

Konsistenca e betonit :

Konsistenca e betonit percaktohet sipas renies ne perputhje me ISO = 109, ose nga prova Vebe ne perputhje

me ISO 4110, ose nga prova e ngjeshjes ne perputhje me ISO 111, ose nga prova e rrjedhshmerise ne perputhje me ISO 9812, ose metoda e testeve alternative

S – 1 10 - 40 mm

S – 2 50 - 90 mm

S – 3 100 –150 mm S – 4 160 - 210 mm S – 5 > 210 mm



Raporti uje - cemento eshte raport i peshes se cimentos ne te.

Permbajtja e ujit duhet te jete efikase per te prodhuar nje perzierje te punueshme te fortesise se specifikuar, por permbajtja totale e ujit duhet te percaktohet nga tabela e meposhtme:

Klasa e betonit	Max. i ujit te lire/ raporti cemento
C- 8/10 (M100) (s)	0,50
C-15/20 (M200) (s)	0,60
C-20/25 (M250) (s)	0,65

PROVAT E FORTESISE SE BETONEVE

Kontraktori duhet te siguroje per qellimet e provave nje set 3 kubikesh per cdo strukture betoni, perfshire derdhje betoni nga 1-15 m³. Per derdhje betoni me shume se 15 m³ duhet te sigurohet nje set shtese 3 kubikesh. Ne se mesatarja e proves se fortesise se kampionit per cdo porcion te punes bie poshte minimumit te lejueshem te fortesise se specifikuar, Supervizori do te udhezaje nje ndryshim ne raportet ose permabjtjen e ujit ne beton ose te dyja ne menyre qe Punedhenesi te mos ketë kosto shtese.

Kontraktori duhet te percaktoje te gjithë kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Ne se rezultatet e testeve te fortesise pas kontrollit tregojne se betoni i perftuar nuk ploteson kerkesat e specifikuara ose kur ka ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifikuara, kampioni do te refuzohet nga Supervizori i Punimeve dhe Kontraktori do te ta rivendose masen e thyer mbrapsh me shpenzimet e veta. Kontraktori duhet te mbuloje me shpenzimet e veta te gjitha provat qe do te behen ne nje laborator qe eshte aprovuar nga Punedhensi.

TRANSPORTI I BETONEVE

Betoni duhet te levize nga vendi i pregatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt te jete e mundur ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kur te jete e mundshme, betoni do te derdhet nga perzieresi direkt ne nje pajisje qe do te beje transportimin e betonit ne destinacionin perfundimtar dhe betoni do te shkarkohet ne menyre aq te mbledhur sa te jete e mundur ne vendin perfundimtar per te shmangur shperndarjen ose derdhjen e tij.

Ne se Kontraktori propozon te perdore pompa per transportin dhe vendosjen e betonit ai duhet te paraqese detaje te plota per pajisjet dhe tekniken e perdorimit te pompes dhe pajisjeve qe ai propozon per te perdorur tek Supervizori i Punimeve.

Ne rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompe, kantieri qe do te perdoret duhet te projektohet per te siguruar rrjedhjen e vazhdueshme dhe te panderprere ne rrepre ose ne gryke (hinke). Fundi i pjerresise

ose i pompes se shperndarjes duhet te jete i mbushur me uje para dhe pas cdo periudhe pune dhe duhet te mbahet i paster. Uji i perdorur per kete qellim duhet te largohet nga cdo ambient pune te perhershme



HEDHJA DHE NGJESHJA E BETONEVE

Kontraktori duhet të ndjekë nga afër procesin e hedhjes dhe ngjeshjes së betonit si një punë me rendesi të madhe, objekt i të cilit duhet të jetë prodhimi i një betoni të papershkueshem nga uji me një densitet dhe fortesi maksimale

Pasi të jetë perziere, betoni duhet të transportohet në vendin e punës sa më shpejt të jetë e mundur, i ngjeshur mirë deri sa të krijojë sipërfaqe të lemuara, pa vrima dhe pa xhepa ajri. Armatura duhet të jetë e hapur në

menyre që të lejojë daljen e bulezave të ajrit dhe betoni duhet të vibrohet me çdo kusht me mjete vibruese për ta bërë sa më të dendur dhe aty ku është e nevojshme. Mjetet vibruese duhet të prodhojnë vibrime jo më pak

së 5000 cikle në minute. Vibratoret duhet të vendosen vertikalisht në beton dhe të terhiqen gradualisht kur fluckat e ajrit nuk dalin më në sipërfaqe. Të gjitha vendet e hedhjes dhe ngjeshjes së betonit duhet të mbahen në mbikqyrje të vazhdueshme nga pjestaret perkates të ekipit të punës.

Betoni duhet të hidhet sa është i fresket dhe para se të ketë fituar qëndrueshmërinë fillestare por gjithmone jo më vonë se 30 minuta pas perzierjes. Kur hedhja e betonit nderpritet, betoni nuk duhet të lejohet të formojë

skaje apo ane por duhet të ndalohet dhe të forcohet mirë në një ndalese të ndertuar dhe të formuar posacerisht për të krijuar një bashkim konstruktiv efikas që është në përgjithësi drejt armatimit kryesor. Para se të hidhet

betoni tjetër, sipërfaqet e të gjitha fugave duhet të kontrollohen, të pastrohen me furçe metalike dhe të lahen. Para se betoni të hidhet në një sipërfaqe të germuar, ky germim duhet të jetë i forcuar dhe pa uje i rrjedhshëm apo të ndenjur, vaj apo lende të tjera të demshme

BETONIMI NE KOHE TE NXEHTE DHE KUJDESI PER BETONET

Kontraktori duhet të tregojë kujdes gjatë motit të nxehtë për të parandaluar carjen apo plasaritjen e betonit. Do të ishte mirë që betoni të hidhet në mëngjez ose natën vonë. Kallepet duhet të mbulohen nga ekspozimi direkt në diell si para vendosjes së betonit ashtu edhe gjatë hedhjes ose vendosjes së tyre

Kujdesi për të gjitha betonet duhet të ndiqet si më poshtë:

- ☐ Sipërfaqe betoni horizontale do të mbahet e lagët vazhdimisht për të paktën 7 dite pas hedhjes. Ato do të mbulohen me materiale ujembajtes si thasë kerpi, pelhure ose menyra të tjera të aprovuara nga Supervizori
- ☐ Sipërfaqe betoni vertikale do të kujdesen fillimisht duke lene armaturat në vend pa levizur dhe duke e mbajtur vazhdimisht të lagët për të paktën 7 dite pas hedhjes. Ato do të mbulohen me materiale ujembajtes si thasë kerpi, pelhure



KALLEPET (ARMATURAT)

Armaturat ose kallepet duhet te jene ne pershtatje me profilet, linjat dhe dimensionet e betonimit te percaktuara ne skicat dhe vizatimet perkatese te fiksuara apo te mbeshtetura me pyka apo mjete te ngjashme per te lejuar qe ngarkimi te jete i lehte dhe format te levizen pa demtime dhe pa goditje ne vendin e punes. Furnizimi, fiksimi dhe levizja e kallepeve duhet te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te dhene per kategorite e ndryshme te betoneve te furnizuar dhe te hedhur ne veper.

Kallepet duhet te ndertohen me vija qe mbyllen lehtesisht per largimin e ujit, materialeve te demshme dhe per qellime inspektimi si dhe me lidhesa per te lehtesuar shkeputjen pa demtuar betonin. Te gjitha mbeshteteset

vertikale duhet te jene te vendosura ne menyre te tille qe mund te ulen dhe kallepi te shkeputet lehte me goditje apo shkeputje. Kallepet per trare duhet te montohen me nje pjese ngritese 6 mm per cdo 3 m shtrirje. Metoda e fiksimit te kallepit faqe te ekspozuara te betonit nuk duhet te perfshijne ndonje lloj fiksimi ne beton ne menyre qe te kemi siperfaqe te sheshta betoni. Asnje bullon, tel nuk duhet te perdoret ne betonim i cili do te jete i papershkueshem nga uji.

Nje tolerance prej 3 mm ne rritje ne nivel do te lejohet ne ngritjen e kallepit i cili duhet te jete i forte, rigjid perkunder betoneve te laget, vibrimeve dhe ngarkesave te ndertimit dhe duhet te mbetet ne pershtatje te plote me skicen dhe nivelin e pranuar perpara betonimit

Te gjitha qoshet e jashtme te betonit qe nuk jane vendosur pergjithmone ne toke duhet tu jepet 18 mm kanal, pervec aty ku tregohet ndryshe ne vizatimet.

Armaturat mund te jene prej druri ose metali por gjithmone ato duhet te jene rrigjide dhe te forta per ti qendruar forces se betonit dhe cdo ngarkese konstruktive. Ne cdo rast ato duhet te jene te mberthyera ne menyre gjatesore dhe terthore.

Pjesa e brendshme e te gjitha araturave duhet te lyhen me vaj liri, nafte bruto ose sapun cdo here qe ato fiksohen ne menyre qe te parandalohet ngjitja e betonit tek armatura.

Armatura duhet te goditet pa tronditur, vibruar ose demtuar betonin. Armatura qe do te riperdoret duhet te riparohet dhe te pastrohet perpara se te rivendoset ne objekt. Siperfaqet e brendshme duhet te pastrohen

komplet para vendosjes se betonit. Ne rast se armatura eshte prej druri siperfaqja e brendshme duhet te laget pikerisht perpara se te hidhet betoni.

Terheqjet, konet, pajisjet larese apo mekanizma te tjere qe lene vrime ne siperfaqen e betonit me $d > 20$ mm nuk do te lihen brenda formave.

Armatura nuk duhet te levizet deri sa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrushmeri te strkutures dhe per te mbajtur ngarkesen ne keputje dhe cdo ngarkese tjeter konstruktive qe mund te veproje ne te.



Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdorjes se veglave ne heqjen e formave. Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Supervizorit te Punimeve megjithate ne cdo rast

Kontraktori eshte pergjegjes per ndonje demtim per punen qe lidhet me to. Me poshte po japim nje guide orientuese per sa i perket kohes se heqjes se armaturave per kallpe te ndryshme:

HEQJA E ARMATURES

Armatura nuk duhet te levizet derisa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrueshmeri te struktures dhe per te mbajtur ngarkesen konstruktive qe mund te veproje ne te. Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdorjes me kujdes te veglave ne heqjen e formave.

Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Mbikqyresit te Punimeve dhe puna e dukshme pas marrjes te nje leje te tille duhet te kryhet nen supervizionin personal te nje tekniku ndertimi kompetent. Kujdes i madh duhet te ushtrohet gjate levizjes se armatures per te shmangur tronditjet ose ne te kundert shtypjen ne beton

Ne rastin kur Mbikqyresi i Punimeve e konsideron qe Sipermarresi duhet te vonoje heqjen e armatures ose per shkak te kohes ose per ndonje arsye tjeter ai mund te urdheroje Sipermarresin qe te vonoje te tilla levizje dhe Sipermarresi nuk duhet te ankohe per vonesa ne konsekuence te kesaj.

Pavaresisht nga kjo ndonje njoftim i lejuar ose aprovim i dhene nga Mbikqyresi i Punimeve, Sipermarresi duhet te jete pergjegjes per ndonje demtim per punen dhe cdo demtim per rrjedhim shkaktuar nga levizja ose qe rezulton nga levizja e armatures.

ANALIZA E CMIMIT NJESI PER BETONET

Cmimi njesi per nje meter kub beton i derdur mbulon furnizimin e inerteve, cimentos, ujit dhe shtesave speciale si dhe perzierjen, hedhjen dhe ngjeshjen ne cdo seksion apo trashesi betoni. Ne kete cmim do te futet edhe kujdesi per betonin, provat dhe te gjitha aktivitetet e tjera qe pershkruhen me siper te cilat jane te domosdoshme per ekzekutimin e punimeve me cilesi.

Mbushja e bashkimeve me material izolues, vendosja e armimit ku te jete e nevojshme, armaturat dhe fuqia puntore e nevojshme jane te perfshire ne cmimin njesi te betoneve.

Cdo volum betoni pertej limiteve te treguara ne vizatime nuk do te paguhet.

Cmimet njesi per zera te ndryshem punime betoni jane si me poshte:

Betone Klasa A& A (M100)(s)	konform STASH 5115-78
Betone Klasa B&B (M200) (s)	konform STASH 5112-78
Betone Klasa C&C (M250) (s)	konform STASH 5112-78



Betone Klasa D&D (M300) (s)

konform STASH 5112-78

7.1.6. Armimi

7.1.6.1. Materialet

- Çeliku per armim te jete i markes FeB 44 K
- Çeliku per armim i prodhuar do te permbushë kërkesat dhe do te sillet ne kantier ne gjendje te shtrire (jo te mbledhur).
- Provat e çelikut do te behen ne perputhje me normat italiane CNR.
- Ne qofte se shufrat perputhen me kërkesat e CNR, Kontraktori do te leshoje nje çertifikate ku te konfirmoje qe mostrat e marra nga shufrat e levruara nga fabrika e kaluan testin. Frekuenca e marrjes se mostrave dhe metoda e kontrollit te cilesise do te jete ne perputhje me tabelen 4.

7.1.6.2. Magazinimi

Hekuri i armimit do te jete i ngritur nga toka dhe i mbrojtur ndaj agjenteve agresiv, mbrojtja do te behet ne barake ose me mbulesa me leter katrama.

7.1.6.3. Kthimi i armatures

- Perforcimet do te kthehen (perkulen) sipas dimensioneve treguar ne grafikun e
 - Me perjashtim se sa lejohet me poshte, te gjitha shufrat do te kthehen ne te ftohte dhe me kujdes pa perdorur presion.
 - Kthimi me te nxehte mund te lejohet me aprovim, per shufrat me diameter ≥ 32 mm.
 - Nuk lejohen prerje me oksigjen (me flake) te shufrave me δ te larte, me perjashtim te rasteve kur e miraton inxhinieri.
- Shufrat e kthyer nuk duhet te drejtohen dhe te riperdoren.

7.1.6.4. Vendosja dhe fiksimi:

Hekuri i armimit duhet te vendoset sic eshte treguar ne vizatimet e projektit dhe te mbahet ne kete pozicion edhe gjate operacionit te betonimit. Ai duhet te sigurohet me ane te lidhjeve ne pikat e takimit (kryqe) me tel celiku me diameter = 1.25 mm, ose me ane te kapseve te duhura ose me saldim kur lejohet nga Inxhinieri. Hekuri i armimit duhet te mbahet ne pozicionin e tij korrekt me ane te vareseve dhe te nivelohet me ane te kavallotave dhe spesoreve, sipas vizatimeve dhe materialeve te aprovuara.

SHENIM: Pavaresisht tolerancave te dhena, trashesia e shtreses mbrojtese perreth shufrave te hekurit duhet te ruhet sic jepet ne vizatimet e projektit.

7.1.6.5. Shtresa mbrojtese:

Me termin shtrese mbrojtese ne kete rast kuptohet, trashesia minimale e paster e betonit midis siperfaqjes se shufres se hekurit dhe faqes se betonit.

Minimumi i shtreses mbrojtese duhet te jete aq sa udhezoon Inxhinieri.

7.1.6.5. Shtresa mbrojtëse:

Me termin shtrese mbrojtëse ne kete rast kuptohet, trashesia minimale e pastër e betonit midis sipërfaqjes së shufres së hekurit dhe faqes së betonit.

Minimumi i shtresës mbrojtëse duhet të jetë aq sa udhëzon Inxhinieri.

Shtresa mbrojtëse mund të rritet në bazë të thellesisë së sejciles sipërfaqe që trajtohet psh. kur betoni është shtyre me goditje me çelik ose kur uljet janë parashikuar

Spesoret që kerkohen për të siguruar që shtresa mbrojtëse të realizohet, duhet të jetë prej materiali, lloji dhe vizatimi të pranuar nga inxhinieri.

Spesoret prej betoni do të behen me dimensione max. 5 mm dhe të jenë prej të njëjtit material si ato që rrethojnë betonin.

Blloqet do të formohen me module speciale dhe betoni do ngjeshet me vibrator banko (të sheshtë) sipas miratimit të Inxhinierit.

7.1.6.6. Lidhjet:

Lidhja ose xhuntimi i shufrave të hekurit punues duhet të behet vetëm sipas menyres së dhënë në vizatimet e projektit ose nëse janë të aprovuara.

Gjatesia e xhuntimit (mbivendosjes) për një bashkim nuk duhet të jetë më e madhe se ajo që jepet në vizatimet e projektit.

7.1.6.7. Kushtet e sipërfaqjes:

Menjëherë para se të realizohet betonimi rreth hekurit, ai duhet të pastrohet, të lirohet nga balta, vaji, graso, boja, ose substanca të tjera që mund të kenë efekte kimike mbi çelikun dhe betonin ose të prishin lidhjen midis tyre.

Punoi: Ing.Arian Baku



MIRATOI

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Ndricim Sinani

